



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

*Qeveria – Vlada - Government*

*Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera – Office of the Prime Minister*

---

**Raport i Koordinatorit Shtetëror i datës 30 dhjetor 2020, për  
rrjedhën e dialogut Kosovë-Serbi që nga rinisja deri në fund të vitit.**

Ky raport përmbledhës është përgatitur nga Koordinatori Shtetëror për Dialog me Serbinë Skender Hyseni për Kryeministrin Avdullah Hoti, si raport vjetor.

---

Pas vendimit politik për të rinisur dialogun me Serbinë, nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, me 1 korrik 2020, Qeveria e Kosovës, me propozim të Kryeministrit Hoti, në mbledhjen e kabinetit, mori vendim për të emëruar një Koordinator Shtetëror për Dialog.

Para kësaj, Shtëpia e Bardhë kishte ftuar një takim të nivelit të lartë midis Kosovës dhe Serbisë i cili duhej të mbahej me 27 qershor në Uashington. Por, derisa delegacioni i Kosovës (Presidenti Thaçi dhe Kryeministri Hoti) ishte nisur për në Uashington, me 26, Prokuroria Speciale e Dhomave të Specializuara lëshoi një njoftim për ngritjen e

aktakuzave ndaj Thaçit dhe kryetarit të PDK-së Kadri Veselit. Publikimi i aktakuzës ndaj presidentit Hashim Thaçi bëri që të dështonte takimi i planifikuar të mbahet në Shtëpinë e Bardhë më 27 qershor. Pas presidentit, i cili e njoftoi emisararin amerikan Richard Grenell se nuk do të jetë pjesë e takimit, pjesëmarrjen e kishte anuluar edhe kryeministri Avdullah Hoti.

I dërguari i posaçëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për dialogun Kosovë-Serbi Richard Grenell kishte thënë se e mirëkupton vendimin e kryeministrit Avdullah Hoti për anulim e pjesëmarrjes së tij në takimin e planifikuar për 27 qershor në Shtëpinë e Bardhë. Ai kishte thënë 'presim të ricaktojmë takimin së shpejti.'

Gjithë këto zhvillime dramatike e tensionuan edhe më tej debatin për dialogun dhe thelluan mospajtimet mes spektrit politik që shkonin nga një ekstrem në tjetrin. Nga ata që bënin thirrje që të ndërpritet çdo dialog me Serbinë deri te ata të arsyeshmit që mbanin qëndrimin se dialogu duhej vazhduar pavarësisht rrethanave të krijuara.

Sidoqoftë, me 7 korrik Kryeministri Hoti bëri një vizitë në Paris, ku takoi Presidentin francez Manuel Macron. Vizita në Paris dhe takimi me Presidentin francez Emmanuel Macron, kishte qenë konstruktiv dhe i frytshëm.

Nderkohë, Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç ishin pajtuar të zhvillojnë me 10 korrik një "samit virtual", që do të ndërmjetësohet nga presidenti i Francës, Emmanuel Macron dhe kancelarja gjermane, Angela Merkel.

Ky samit, që u zhvillua përmes një video-lidhje, kishte për qëllim uljen e tensioneve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. BE-ja në këtë samit përfaqësohej nga përfaqësuesi i lartë, Joseph Borrell.

“Sami virtual” i parapriu takimit të thirrur për 16 korrik në Bruksel, ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiç, në kuadër të dialogut që ndërmjetësohet nga Bashkimi Europian. Ishte ky takim i parë i drejtëpërdrejtë në kuadër të dialogut të Brukselit pas mëse 20 muajsh.

Ky takim, i pari pra pas rifillimit të dialogut, u përcoll me kritika, krejt kozmetike dhe të papërqëndruara dhe nonsense të tipit foli serbisht, nuk foli serbisht...!

Përfaqësuesit e Beogradit dhe Prishtinës u mirëpritën në fillim nga kreu i diplomacisë evropiane, Josep Borell, ndërsa i dërguari i posaçëm i BE-s për dialogun, Miroslav Lajçak, do poashtu marrte pjesë në takim.

Kryeministri Avdullah Hoti, kishte vullnet shume pozitiv për të berë gjënë e duhur. Në këtë frymë ai kishte vendosur të krijonte trupat e domosdoshme për dialog.

Kështu, me 21 korrik 2020, Kryeministri Hoti, në pajtim me vendimin e 1 korrikut të Qeverisë, me ftoi në zyren e tij në Qeveri dhe me kërkoi që të mirrja pergjegjësinë, përkatësisht pozitën e koordinatorit shtetëror për dialog. Pasi emërmit, koordinatori shtetëror dhe kryeministri trajtuan aspekte të ndryshme rreth pergatitjes sa më të mire për dialogun që duhej të rifillonte që të nesermën. U dakorduan edhe rreth përbërjes së ekipeve, varësisht nga temat që do te diskutoheshin.



Vetëm 24 orë pas emërimit, koordinatori shtetëror, në krye të delegacionit të Kosovës, udhëtoi për Bruksel, për takimin e parë me delegacionin serb, që udhëhiqej nga kryenegociatori Marko Gjuriq. Pra, koha ishte shumë e shkurtër. Delegacioni u nisë për Bruksel, me 22 korrik. Në delegacion ishte edhe Ibrahim Makolli, i ngarkuar me çështjen e të pagjeturëve në Zyren e kryeministrit.

Më 23 korrik, 10 minuta para orës 9, në hyrje të EEAS (European External Action Service) delegacioni u prit nga protokoli i Zyrës së Miroslav Lajçakut. Takimi i parë tet-a-tet (Lajçak-Hyseni) zgjati 30 minuta. Lajçakut iu bë me dije se Kosova në Bruksel nuk vjen për të negociuar çështje të veçanta me Serbinë. Kjo qasje duhet të evitohet nëse duam sukses të dialogut. Kosova synon një marrëveshje gjithëpërfshirëse e cila do rezultoj me njohje reciproke midis Kosovës dhe Serbisë. Koordinatori shtetëror, në këtë takim, shprehu shqetësimin se zyrtarët e BE-së, duke përmendur komisionerin Borell në rend të parë, nuk ishin të qartë fare se ku do të na nxirrte ky dialog. Pas insitimit këmbengulës, Lajçak tha se në fund të procesit, edhe BE-ja nuk shihte zgjidhje tjetër pos normalizimit dhe njohjes reciproke. Kjo nuk mund të thuhet hapur ende, theksoi ai, dhe shtoi se, përgjatë procesit, palët duhet të kenë mundësinë e paraqitjes së qëndrimit të tyre rreth të gjitha çështjeve.

Pas këtij takimi, një orë më vonë nisi takimi i parë trepalësh. Në rend dite ishte tema për të pagjeturit. Pas dy raundeve të negociimit, u arrit dakordimi me tekstin përfundimtar, i cili ishte i shkurtër dhe përbënte një zotim krejtësisht parimor për obligimet që palët do mirrnin vetëm pas nënshkrimit të marrëveshjes gjithëpërfshirëse për normalizim dhe njohje.

Takimi i dytë në Bruksel u vendos të thirrej pas një jave, me 30 korrik për të biseduar për temat: 1. Bashkëpunimi ekonomik dhe 2. Të zhvendosurit.

Ky takim i cili poashtu zgjati gjithë ditën nuk prodhoi asnjë dakordim për përmbajtjen e tekstit të propozuar në fund nga i derguari I BE-së Lajçak. Delegacioni i Kosovës ndërkaq dha pëlqimin por delegacioni serb nuk e pranoi.

Në margjina të takimit të dytë në Bruksel, koordinatori shtetëror Skender Hyseni zhvilloi një takim të rëndësishëm dhe përmbajtësor me Asistent Sekretarin Kryesor për Evropë dhe Euroazi në Departamentin Amerikan të Shtetit, Philip Reeker, I cili po qëndronte në Bruksel për të takuar Miroslav Lajçakun dhe zyrtarë tjerë të BE-së.

Takimi shumë i përzemërt me ambasadorin Reeker ishte rast i mire për një bisedë të hapur rreth zhvillimeve në Kosovë dhe rajon, me theks të veçantë në dialogun e rinisur midis Republikës së Kosovës dhe Serbisë në Bruksel. Krahas BE-së. Koordiantori shtetëror theksoi se roli I SHBA-ve në këtë process ishte i pazëvendësueshëm. Reeker siguroi se përkushtimi amerikan ishte i palëkundur, në përkrahje të dialogut dhe se Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të ishin me Kosovën përgjatë gjithë këtij procesi, në përkrahje të fuqishme për një marrëveshje të drejtë, të qëndrueshme dhe gjithpërfshirëse. Në bisedë e sipër Philip Reeker prpopzoi që koordinatori shtetëror të vizitonte Uashingtonin sa më parë. E vlerësonte të rëndësishme që të bëhshin takime me njerzit kryesor në Shtëpi të Bardhë dhe DASH, që bëjnë politikën për dhe rreth Kosovës.

Pas kthimit nga Brukseli koordinatori shtetëror filloi një seri takimesh informuese dhe bashkërenduese me përfaqësues të frocave



parlamentare politike. Siq nuk pritej hiq, Ramush Haradinaj, kishte filluar të ipte deklarata që shkonin kundër çdo logjike racionale politike. U tregua shumë sedërhollë me kryeministrin Hoti. Deklaronite se KM Hoti nuk e kishte konsultuar paraprakisht për emërimin e koordinatorit. Nuk kishte të drejtë sepse vendimi për emërimin e një koordinatori shtetëror për dialog ishte votuar në mënyrë unanime në qeveri. 'Për' kishin votuar edhe të gjithë ministrat nga AAK, përfshi edhe zv.kryeministrin Besnik Tahiri. Pra, pas këtij votimi mbetet tërësisht në diskrecion të kryeministrit Hoti të përcaktohet për emrin.

Pavarësisht nga kjo koordinatori bëri përpjekje që të kontaktonte AAK-në për informim rreth rrjedhës së takimit të parë.

Takimet dhe kontaktet me pjesën tjetër të spektrit politik vazhduan. U bë përpjekje të kontaktohet Albin Kurti i cili nuk përgjigjej. U kontaktohet në telefon z.Rexhep Selimi, në cilësinë e tij të kryetarit të Grupit Parlamentar të VV-së. Ju spjegua arsyeja e thirrjes, që pavarësisht a do të marrë pjesë VV-ja në negociata apo jo, kishte gatishmëri që të njoftohej edhe ky subjekt politik me rrjedhën e procesit në çdo fazë. Rexhep Selimi, me korrektësi maksimale, ishte falenderuar për telefonatën duke premtuar se kërkesa do t'i përcillej z.Kurti. Nga VV nuk u erdhi asnjë përgjigje.

Sidoqoftë, me 29 korrik, koordinatori pati një takim dhe bisedë përmbajtësore me nënkryetarin e PDK-së z. Enver Hoxhaj, i cili për këtë takim ishte autorizuar nga Kryetari i PDK-së Kadri Veseli. Dialogu Kosovë Serbi në Bruksel ishte në fokus të bisedës. Z. Hoxhaj u njoftua rrjedhën e takimeve. U theksua nevoja e koordinimit të ngushtë dhe bashkërendimit në këte, dhe të gjitha çështjet tjera të rëndësishme nacionale duke ndërtuar unitet dhe konsensus sa më të gjerë politik në Kosovë!

Me 29 korrik, vetëm pak orë para nisjes për Bruksel, koordinatori takoi dhe bisedoi me z. Fatmir Limaj, kryetar i NISMA-s. Takimi dhe biseda ishte tejet përmbajtësore dhe inkurajuese. Natyrisht, edhe këtu dialogu Kosovë Serbi në Bruksel ishte në fokus të bisedës.

Pra, takimi i dytë në Bruksel u vendos të thirrej një javë pas takimit të parë, me 30 korrik për të biseduar për temat: 1. Bashkëpunimi ekonomik dhe 2. Të zhvendosurit.

Ky takim i cili poashtu zgjati gjithë ditën nuk prodhoi asnjë dakordim për përmbajtjen e tekstit të propozuar në fund nga i derguari I BE-së Lajçak. Delegacioni ynë dhamë pëlqimin por delegacioni serb nuk e pranoi.

Ndërkohë, me ambasadoren Çitaku dhe me Mathew Palmer po vazhdonte planifikimi dhe organizimi i vizitës së koordinatorit dhe agjendës në Washington. U vendos që të udhëtohej nga Brukseli, pas takimit të dytë me delegacionin serb.

Nga Brukseli, koordinatori arriti në Uashington pasditën e 2 gushtit. Ndërsa me 3 dhe 4 gusht, zhvilloi një varg takimesh.

Kështu, takimi i parë ishte me Zëvendës Asistent-Sekretarin për Evropë dhe Euroazi në Departamentin Amerikan të Shtetit, Matthew Palmer, i cili poashtu mbante edhe pozitën Emisarit Special amerikan për Ballkanin Perendimor. U bë një bisedë të hapur për rrjedhën e dialogut në Bruksel. Biseda me Zotin Palmer ishte e hapur pra, dhe në momente, edhe kundërshtuese dhe shterruese. Ja prezantova troq shqetësimin tonë dhe, edhe të opinionit publik e politik në Kosovë përgjithësisht, për mospraninë aktive edhe fizike amerikane në tryezën e bisedimeve.



Pallmer tha se DASH ishte në koordinim dhe kontakt të përhershëm me Miroslav Lajçakun. Duke u lutur që të mos behej publike ende, ai siguroi se në takim në nivel të lartë të thirrur për datën 7 shtator, perfaqësuesi amerikan do të ishte në Bruksel.

Në bisedë me Pallmer koordinatori Hyseni kërkoi që Kosova të mos vihej në pozitë që të përcaktohet apo të marrë anë. Kjo është e padrejt dhe fundja edhe punë që nuk bëhet, iu tha Palmerit duke shtuar se Kosova është e pafuqishme të futet midis Amerikës dhe BE-së në përgjithësi. Kosova është e pafuqishme të ushtroj çfardo ndikimi në këtë rrafsh dhe fundja është shumë padrejt e madje edhe jokorrekte që të vihem në pozicion për të zgjedhur. Marrëdhëniet transatlantike janë çështje në të cilat asesi nuk mund të implikohet Kosova, sepse nuk e ka as fuqinë e as komoditetin e marrjes anë.

Koordinatori Hyseni theksoi dhe bëri thirrje, prandaj, që SHBA të kyqet në mënyrë aktive në dialog, krahas BE-së.

Palmer tha se DASH kishte mirëpritur emërimin e një koordinatori për dialog në Kosovë dhe se SHBA çmonte angazhimin konstruktiv të Qeverisë dhe të gjitha institucioneve Republikës së Kosovës në këtë process, duke shtuar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës përkrahin dialogun në Bruksel. Ai tha se SHBA do të jet në tavolinën e bisedimeve gjatë takimit që ishte caktuar të mbahej me 7 shtator midis Kryeministrit Hoti dhe Presidentit serb Vuqic.

Pas takimit me Mathew Palmer, koordinatori zhvilloi një bisedë të gjatë me z. Ryan Tully, Drejtor i Lartë dhe znj Amanda R. Ahlers, Drejtore për Evropë në Këshillin për Siguri Kombëtare të Shtëpisë së Bardhë. Biseda poashtu kishte në focus dialogun e rinisur në Bruksel por edhe zhvillimet e përgjithshme në Kosovë dhe rajon. Ndërsa po at dite në pamundësi të takimit në Washington (Ambasadori Grenell ishte në Kaliforni) zhvilloi një



një bisedë të gjatë telefonike me Ambasadorin Richard Grenell i Dërguar i Posaçem i Presidentit Trump për dialogun Kosovë Serbi.

Duke kërkuar mendimin, Grenell njoftoi koordinatorin Hyseni se po palnifikonte të thirrte një takim Hoti Vuqic diku nga fundi i gushtit ose fillimi i shtatorit në Shtëpinë e Bardhë.

A mund të llogarisim në përgjigje positive nga Kosova, nëse vendosim për të organizuar këtë takim, pyeti direkt Grenell koordinatorin Hyseni, i cili i dha përgjigje të qartë PO. Konsidero se e ke pëlqimin e Kryeministrit Hoti dhe konfirmimin se Hoti me delegacionin e tij do të marrë pjesë në takim kurdo që të thirrej. Në këtë pikë ai (Grenell) tregoi se kishte biseduar edhe me Presidentin serb Vuqic, por që ende nuk kishte marrë një konfirmim të prerë.

Natyrisht, në pritje të thirrjes të një takimi të tillë, me kryeministrin Hoti e kishim biseduar disa herë, dhe ishim dakorduar që poqëse do të vinte një ftesë e tillë ne do ti themi po.

Biseda telefonike me ambasadorin Grenell përfundoi duke u dakorduar që të fillohet me përgatitjet për takimin, posa ta mirrte konfirmimin edhe nga pala serbe.

Vizita e koordinatorit në Uashington vazhdoi edhe me disa takime të veçanta. Në Senatin amerikan u prit nga Santori republikan Ron Johnson, i cili është aktivisht i interesuar për raportet Kosovë Serbi. U zhvillua një bisedë e hapur rreth dialogut dhe perspektivës së një marrëveshje gjithëpërfshirëse për njohje reciproke dhe normalizim midis Republikës së Kosovës dhe Serbisë.

Të njejtën ditë, në zyrat e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Washington, koordinatori priti për një takim të veçantë edhe z. Caleb Charles McCarry nga zyra e Shefit Ekzekutiv të Korporatës Financiare

Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (U.S. International Development Finance Corporation -DFC). U bisedua për një varg idesh për projekte investive që kjo korporatë synon të zbatojë në infrastrukturë dhe fusha tjera në Kosovë dhe rajon. Më vonë atë ditë, një takim dhe bisedë tjetër shumë përmbajtësore u bë me z. James Carafano, z. President i Insitutit Davis të Fondacionit Heritage për Siguri Nacionale dhe Politikë të Jashtme.

Me kërkesën e tyre, ditën e fundit të vizitës koordinatori pati dy takime të veçanta shumë të rëndësishme me ambasadorin e Republikës Franceze në Amerikë Philippe Étienne dhe me ambasadorën e Republikës Federale të Gjermanisë Emily Haber në Uashington.

Këto dy takime duhet vlerësuar si shumë të rëndësishme, sepse ishin rast i mirë për të trajtuar hapur gjithë dimansionin e këtij procesi. Edhe ambasadori francez edhe ajo gjermane, në fund të takimeve i bënë ftesë koordinatorit Hyseni që të vizitonte Parisin dhe Berlinin me qëllim të koordinimit rreth dialogut.

Pas kthimit nga Uashingtoni, në Prishtinë vazhduan me takimet informuese me përfaqësues partish dhe shoqërisë civile.

Me 10 gusht 2020, në ora 10, koordinatori prita në zyren e tij Dardan Molliqajn, Ndërsa me 11 gusht, pati takime të ndara me Adriatik Kelmendin dhe Berat Buzhalën, rreth idesë time që ishte dakorduar edhe Kryeministrit Hoti, që në baza periodike të organizoheshin takime dhe biseda më disa përfaqësues të shoqërisë civile, duke aplikuar "Chatham House Rules of non-disclosure". Edhe Adriatiku edhe Berati u pajtuan.



Po të njetën ditë u bë për herë të dytë edhe një takim me Fatmir Limajn, kryetar I NISMA-s. Me Fatimirin biseda u përqëndrua në vizitën e koordinatorit Hyseni në Amerikë dhe porosive kyçe që silleshin nga takimet e shumta atje.

Poashtu, u trajtuan opsione të ndryshme të ndërtimit të një konsensusi sa më të gjërë dhe sa më funksional karshi çështjeve të rëndësisë nacionale siq ishte dialogu me Serbinë

Ditët në vijim koordinatori shtetëror Hyseni priti në takime shumë diplomatë dhe ambasadorë të akredituar në Prishtinë nga vende të ndryshme. I ngarkuari me punë i Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë, z. Jan-Axel Voss, erdhi në takim dhe propozoi disa data të mundshme për vizitën e koordinatorit në Berlin. Ndërsa me 17 gusht, koordinatori Hyseni në zyrën e tij tij në Kryeministri priti ambasadorën e Republikës Franceze në Prishtinë Marie-Christine Butel.

Kishte ardhur, mes tjerash edhe për t'u dakorduar për një datë për vizitën në Paris.

Takimet në Paris, koordinatori shtetëror Hyseni, i shoqëruar nga ambasadori i Kosovës Qëndrim Gashi, i filloi në Pallatin Presidential Elysee. Takimi me këshilltarin diplomatik të Presidentit Macron, Alexandre Adam, ishte i gjatë dhe përmbajtësor. Duke vlerësuar rolin e madh të Francës dhe Presidentit Macron, z.Adam u njoftua shkurt për rrjedhën e dialogut në Bruksel. Biseda ishte e hapur dhe shterruese, në frymë mirëkuptimi të plotë.

Poashtu, duke çmuar angazhimin e BE-së dhe punën e të dërguarit të veçantë të saj, Ljçak në raundet e bisedimeve që po zhvilloheshin në Bruksel, koordinatori Hyseni theksoi rëndësinë thelbësore të përkushtimit të Presidentit Makron dhe Kancelarës gjermane Merkel. Koordinimi Uashington-Paris-Berlin është imperativ, theksoi Hyseni.



I vëdijshtëm që Lajçak dërgonte raporte të detajuara në qendrat kryesore, sidomos në Paris dhe Berlin, pas çdo raundi bisedimesh në Bruksel, koordinatori Hyseni theksoi se nuk duhet të humbet koha e çmueshme, duke zvarritur procesin, i cili në fund do të dështojë nëse nuk shtrohet pa u vonuar dhe pa zvarritje, për diskutim dhe akordim çështja kryesore, marrëveshja gjithëpërfshirëse për njohje reciproke dhe normalizim midis Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Kjo mund të arrihet vetëm me përfshirjen dhe përkrahjen e drejtëpërdrejtë dhe të koordinuar të trekëndshit Paris, Berlin, Uashington.

Alexandre Adam dëgjoi me kujdes, ndërkohë që po shkruante çdo fjalë që po thuhej. Koordinatori Hyseni me këtë rast i dorëzoi z. Adam Dokumentin "Qëndrimi i Republikës së Kosovës për Dialogun me Republikën e Serbisë".

Nderkaq, në një takim tjetër të gjatë dhe shumë përmbajtësor, Hyseni u prit në Quai d'Orsay nga ambasadori Frederic Mondoloni, Drejtor për Evropë Kontinentale në MPJ të Francës. Tema e bisedës edhe në këtë takim ishte dialogu Kosovë Serbi

Poashtu në këtë takim me ambasadorin Mondolini u bisedua edhe për liberalizimi e vizave për qytetarët e Kosovës. Me përunjësi u kërkua që edhe Franca përfundimisht të jap pajtimin e saj që liberalizimi të ndodh brenda këtij viti.

Në të dyja takimet u përcoll mesazh i qartë se Franca dhe Presidenti Macron mbetëm të përkushtuar përgjatë gjithë këtij procesi, në përkrahje të fuqishme të një marrëveshje të drejtë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Pas kthimit nga Parisi, dhe shume takimeve informuese me liderë dhe zyrtarë qeveritarë të Kosovës, me 24 gusht, në zyrën e tij koordinatori

Hyseni priti ambasadorin e Britanisë së Madhe, Nicholas Abbott. U bë një bisedë të hapur për rrjedhën e dialogut Kosovë-Serbi. Duke çmuar lartë kontributin e madh të Britanisë së Madhe në të gjitha fazat e historisë më të re dhe shtetndërtimit në Kosovë, Hyseni theksoi rëndësinë e veçantë që ka përkrahja e mëtejme britanike për proceset nëpër të cilat po kalonte vendi ynë. Ambasadori Abbott, nga ana e tij tha se përkushtimi dhe angazhimi i Mbretërisë së Bashkuar, për një marrëveshje të drejt dhe të qëndrueshme që duhet të sjell normalizim të plotë në marrëdhëniet midis Kosovës dhe Serbisë, është i palëkundshëm. Ambasadori Abbott bëri me dije se Londra, me fondet e saja, ishte e vullnetshme që të ofronte një këshilltar britanik i cili do të vendosej në Prishtinë për të punuar për zyren time. Pas disa javësh Boyd McKechnie, u angazhua për të punuar në Zyrën e kooridnatorit shtetëror Hyseni.

Poashtu ambasadori Abbott i bëri ftesë kooridnatorit Hyseni që të vizitonte Londrën sa më parë që të ishte e mundshme për takime me zyrtarët kryesor që kanë Kosovën si portfolio. U ra dakord që vizita të behej menjëherë pas takimit në nivel të lartë (Hoti-Vuqiç) në Shtepinë e Bardhë me 4 shtator dhe atij në Bruksel me 7 shtator.

Në kuadër të koordinimit dhe këmbimit të pikëpamjeve e qëndrimeve rreth dialogut me Serbinë, me 25 shtator, në Berlin kooridnatori Hyseni zhvilloi dy takime të veçanta. Në kabinetin e kancelarës Angela Merkel u prit nga z. Matthias Lüttenberg, Kryesues i Divizionit për Marrëdhënie Bilaterale me Shtetet e Evropës Qendrore, Lindore, si dhe Azisë Qendrore. Ndërkaq, një takim tjetër të gjatë dhe shumë përmbajtësor, zhvilloi në Ministrinë e Punëve të Jashtme të RFGJ, ku u prit nga ambasadori Michael Siebert dhe Zonja Christiane Hullman, Shefe e



Divizionit për Ballkanin Perendimor.

Që në fillim të takimeve u theksua se qeveria dhe të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës shohin te Republika Federale e Gjermanisë një vend mik, shtëpi të dytë për një numër të madh kosovarësh. Nënvizova se kjo, dhe përkrahja e pakursyer gjermane për Kosovën dhe popullin e saj, në orët më liga të historisë, kanë krijuar një lidhje të veçantë midis popujve dhe vendeve tona.

Duke shprehur mirënjohjen e thellë për përkushtimin e kancelarës Merkel dhe rolin e veçantë të Gjermanisë për përmbylljen e shpejtë të dialogut me njohje të ndërsjellë midis Kosovës dhe Serbisë, Hyseni bëri thirrje që të bëhen hapa të vendosur në vijim të dialogut.

Me z. Lüttenberg dhe me ambasadorin Siebert pra, në frymë mirëkuptimi të plotë, u bë një bisedë e hapur dhe shumë përmbajtësore. Pasi u njoftuan për rrjedhën e takimeve në Bruksel, u trajtuam disa nga aspektet e veçanta, gjithnjë me synimin që ky dialog të strukturohet dhe të përshpejtohet.

Koordinatori Hyseni theksoi se adresimi dhe nënshkrimi i marrëveshjes pas negociimit të elementeve të saj, garanton sukses të dialogut dhe rrjedhimisht edhe një stabilitet afatgjatë dhe frymë të mirëfilltë bashkëpunimi në Ballkanin Perendimor. Nikoqirët u siguruan se angazhimi konstruktiv i Qeverisë Hoti dhe i të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës në këtë në këtë drejtim është i vendosur. Kosova synon paqe, bashkëpunim dhe raporte normale fqinjësore me Serbinë, njësoj si me vendet tjera të rajonit.

Njësoj si në Paris, edhe në Berlin mesazhi ishte i qartë. Gjermania dhe Kancelarja Merkel mbeteshin fuqimisht të përkushtuar në përkrahje të fuqishme të një marrëveshje të drejtë, të qëndrueshme dhe gjithpërfshirëse. Në bisedat që u zhvilluan në Berlin vërehej një



konvergencë pothuaj totale në qëndrimet e Francës dhe Gjermanisë rreth dialogut dhe epilogut pëfundimtar të tij, që duhej të ishte njohja e ndërsjellë.

Me 26 gusht nga Berlioni, koordinatori shtetëror Hyseni udhëtoi për në Bruksel, ku të nesërmen do të mbahej takimi i radhes (i tretë) me delegacionin serb. Atje e priste pjesa tjetër e delegacionit, Muhamet Mustafa, Gazmend Qorraj, Ibrahim Makolli dhe Sytrime Dervisholli.

Ashtu siq edhe pritej Serbia kishte ardhur e përgatitur për të mainpular procesin duke tentuar ta kthente në biseda teknike. Pas takimit koordinatori Hyseni për, media ishte grafik dhe deklaroi: "Pala serbe sot është treguar jokonstruktive. Kosova edhe sot ka vazhduar të jetë shumë konstruktive në kuptim të mbrojtjes rigoroze të interesave të saj, por në të njëjtën kohë duke qenë pala që e ka përnjëmend këtë proces dhe synon të arrijë marrëveshje paqeje e normalizimi me Serbinë. Pa shmangshëm kjo marrëveshje duhet të sjellë njohje reciproke midis Kosovës dhe Serbisë. S'mund të ketë asnjë marrëveshje tjetër".

Pas kthimit në Prishtinë, ishte vetem një vikend për t'u bërë gadi për të udhëtuar për Uashington për takimin në Shtëpine e Bardhë.

Delegacioni i parë nga Kryeministri Avdullah Hoti në përbërje të të cilit përpos koordinatorit shtetëror Hyseni ishin edhe zv.kryeministrat Driton Selmanaj e Albulena Halimi-Balaj, si dhe ministrat Arban Abrashi, Selim Selimi, Meliza Haradinaj dhe Ardita Dushi, shefe e kabinetit të KM, arriti në Amerikë, të hënën, me 31 gusht, pasdreke.

Në të njëjtin aeroplan me delegacionin ishin edhe një ekip kulminantë gazetarësh nga Prishtina, Adriatik Kelmendi, Berat Buzhala dhe Leonard Kerquku.

Një ditë para takimit në Shtëpinë e Bardhë koordinatori shtetëror mori një letër nga Miroslav Lajçak, ku njoftonte me agjendën dhe temat e takimit në nivel të lartë të 7 shtatorit.

Mes tjerash shkruante se do të diskutohet për asociacionin dhe pretendimet financiare. Tema këto për të cilat, sipas Lajçak ishin dakorduar kryeministri Hoti dhe presidenti serb Vuçiç që në takimin e parë.

Me 3 shtator, në ora 9:30, nisi takimi në Shtëpi të Bardhë. Ndërsa të nesermën me 4 shtator, në zyrën e Presidentit Trump dhe në praninë e tij u nënshkrua marrëveshja.

Nga Uashingtoni, i gjithë delegacioni u largua pasditen e 5 shtatorit me United Airlines për të arritur në Bruksel të nesermën, e dielë, në ora 7 të mëngjesit.

Vetëm pak orë pas arritjes koordinatori Hyseni kishte takim me palën serbe që ishte planifikuar për orën 11:00. Një ditë më parë, Muhamet Mustafa, Gazmend Qorraj, Ibrahim Makolli dhe Sytrime Dervisholli kishin zhvilluar një takim me palën serbe në nivel ekspertësh. Një orë para takimit me delegacionin serb me Marko Gjuriqin në krye të tij, koordinatori Hyseni takoi Profesor Mustafën dhe ambasadorin Bernard Nikaj për t'u njoftuar me rrjedhën e takimit të ekspertëve, i cili kishte përfunduar pa asnjë dakordim rreth tekstit të elementeve të marrëveshjes për të pagjeturit, të zhvendosurit dhe për marrëdhëniet ekonomike. Delegacionit të ekspertëve u ishin lënë instruksione të qarta dhe të prera që të bisedonin por të mos ipnin asnjë pëlqim përpara se delegacioni të kthehej nga Amerika.

Pasdite, në ambasadën tonë në Bruksel, Kryeministri Hoti, i shoqëruar edhe nga koordinatori Hyseni, priti në një takim të përbashkët Matthew Palmerin dhe Miroslav Lajçakun. Në takim ishte i pranishëm dhe ambasadori Nikaj.

Ndërsa, të nesërmen, 7 shtator, u zhvillua takimi i dyte Hoti-Vuqiç. Në prani të Borell, në fillim për të vazhduar pastaj me z. Lajçak. Palet u dakorduan për tekstin e tre elementëve të marrveshjes: Marrëdhëniet Ekonomike; Të pagjeturit; dhe Të zhvendosurit, me anekset përkatëse.

Pas kthimit me 9 shtator në Prishtinë, gjithnjë në kuadër të koordinimit dhe informimit reciprok, vazhduan takimet e shumta.

Me 10 shtator, në zyrën e tij, koordinatori Hyseni priti ambasadorin e sapoemëruar të Republikës Federale të Gjermanisë në Kosovë, Joern Rohde. U bisedua për rrjedhën dialogut Kosovë-Serbi. Duke çmuar lartë kontributin e madh të Gjermanisë dhe përkrahjen për Kosovën, dhe përkushtimin e Kancelarës Merkel, u theksua rëndësia e veçantë që ka përkrahja e mëtejme gjermane për proceset nëpër të cilat po kalon vendi ynë. Ambasadori Rohde, nga ana e tij siguroi se përkushtimi dhe angazhimi i Gjermanisë për Kosovën dhe rajonin mbetet i palëkundshëm.

Ndërsa me 11 shtator Hyseni priti ambasadorin e Norvegjisë në Kosovë, Jens Erik Grondahl, me të cinin poashti biseduan për rrjedhën e dialogut Kosovë-Serbi. Vetëm dy ditë më vonë koordinatori Hyseni priti të dërguarin e posaqëm të Norvegjisë për Ballkanin Perendimor, ambasadorin Arne Sannes Bjornstad. Bisedë e gjatë mbi rrjedhën e dialogut Kosovë-Serbi, perfundoi me oferten gjeneroze të qeverisë



norvegjeze për të ofruar përkrahje financiare për angazhimin e ekspertëve për dialogun. Pak javë me vonë Kryeministri Hoti dhe Ambasada Norvegjeze do të nënshkruajnë memorandum mirëkuptimi për angazhimin e një numri ekspertësh, program që do të financohet nga Norvegjia.

Me 15 shtator me ambasadorin e Italisë, Nicola Orlando, z. Hyseni pati një takim dhe bisedë të hapur dhe përmbytësore për dialogun Kosovë-Serbi dhe situatën e përgjithshme në Kosovë. U Çmua lartë kontributi i madh i Italisë në të gjitha fazat e historisë më të re dhe shtetndërtimit në Kosovë. Orlando percolli ftesën për vizitë Italisë sa më parë që të ishte e mundëshme.

Takimi i radhës në Bruksel ishte thirrur për datën 17 shtator, ku me delegacionin serb pritej të diskutohet për pretendimet, përkatësisht obligimet financiare dhe pronën. Nuk ishte e qartë nëse delegacioni serb do të vinte në Bruksel fare meqë insistonin që në agjendë të futej edhe tema e hartimit të statutit të asociacionit të komunave me shumicë serbe. Ne refuzonim kategorikisht të trajtojmë këtë temë pas zhurmës dhe deklarimeve iracionale të liderëve partiak dhe shtetëror në Prishtinë të cilët refuzonin të bisedohej për këtë temë. Po zhvillohej një garë totalisht e papranueshme dhe e papërgjegjëshme se cili ishte më 'patriot' se tjetri.

Të gjitha kundërshtimet bëheshin ekskluzivisht për poena të lirë politike, sepse Marrëveshja e Asociacionit tashmë ishte obligim ndërkombëtar dhe detyrim për zbatim, pas ratifikimit në Kuvendin e Kosovës. Pra, në dialogun e Brukselit, kerkohej vetëm hartimi I statutit të asociacionit sipas marrëveshjes së nënshkruar dhe ratifikuar. E statuti do të zbatohet vetëm pas nënshkrimit të marrëveshjes për njohje.

Përballë kësaj situate, KM Hoti dhe koordinatori Hyseni i bënë kërkesë Lajçakut që asociacionin të mos e fuste në agjendë derisa të mirrej pëlqimi i liderëve në Prishtinë.

Sidoqoftë Lajçak njoftoi se delegacioni serb ishte pajtuar që në takimin e 17 shtatorit të diskutonim vetëm temën e obligimeve financiare.

Keshtu, me 17 shtator në mengjes filloi takimi dhe shqyrtimin i pikes së paraparë. Në ekip koordinatori Hyseni kishte profesorët Muhamet Mustafa dhe Robert Muharremi të cilët kishin bërë një punë të shkëlqyeshme në përgatitjen e platformës për këtë temë.

Diskutimet ishin shumë të ashpra, më të tnesionuarat deri atehere. Pala serbe nxorri në tavolinë propozime tërsisht të parpanueshme dhe irracionale, gjë që bëri edhe Lajçakun të humbiste kontrollin.

Reagimi i delegacionit të Kosovës në propozimet serbe ishte i rreptë por i bazuar në fakte e argumente, edhe historike po edhe substanciale.

Takimi mbaroi pa asnjë dakordim, pos pajtimit në parim që të dyja palët të dërgojmë propozimet tona te zyra e Lajçakut.

Lajçak propozoi që për takimi i radhës të thirrej me 28 shtator, ndërsa vetëm një ditë më vonë, pra me 29 shtator tha se do të thirrej takimi tjetër në nivel të lartë.

Pra takimet e radhës dhe agjenda mbeteshin vetëm në tentativë. Me këto qëndrime, delegacionet u larguan nga Brukseli.

Nga Brukseli koordinatori Hyseni udhëtoi për Londër ku pritej të takohet me zyrtarë të lartë të Mbretërisë së Bashkuar. Ambasadori Abbott në Prishtinë kishte bërë punë të madhe që kjo vizitë të ndodhte.

Me 2i shtator, koordinatori Hyseni filloi takimet me një drekë pune me ambasadorin Andreww Page, drejtor për Ballkanin në FCDO, pastaj në



zyrën e saj u prit nga Znj. Wendy Morton, ministre për Evropë dhe Amerikë. Ndërsa me kryesuesin e grupit për Kosovën në parlamentin britanik, Martin Vickers u takua në Parlament.

Një takim shumë të përzemërt pati poashtu edhe me baroneshen Cathrene Ashton.

Takimet dhe bisedat në Londër ishin tepër të rëndësishme, për faktin se Britania e Madhe ishte në një pozicion unik për të balancuar midis Uashingtonit dhe Brukselit, tani që më nuk ishte pjesë e BE-së.

Pas kthimit nga Londra në takime të ndara Hyseni priti ambasadorin e Austrisë në Kosovë, Christoph Weidinger dhe atë të Zvicrës Thomas Kolly. Tema e asociacionit tashmë ishte bërë pjesë e një debati irracional politik dhe rrëshimisht medial.

Ndërkohë, Lajçak ishte pajtuar që edhe në takimin e 28 shtatorit për të cilin tashmë kishin ardhur ftesat të bisedohej vetëm për pretendimet financiare. Ndërsa kishte vendosur që takimin Hoti-Vuqiç të paraprë për 29 shtator ta shtynte për një datë tjetër. Dhe, ndërsa ishin bërë të gjitha përgatitjet për të udhëtuar, me 25 shtator nga Zyra e Lajçak erdhi njoftimi se takimi ishte anuluar, Shkak, gjoja ishte një antar i stafit të Lajçak i testuar pozitiv me Covid-19. Në të njejtën kohë u anulua edhe një vizitë e paralajmëruar e Lajçakut në Kosovë.

Krahas të gjitha këtyre zhvillimeve, në Prishtinë vazhdonte 'përleshja' rreth asociacionit.

I ngarkuari me punë në Ambasadën gjermane, Jean-Axel Voss, kerkoj takim. Koordinatorin Hyseni e priti në zyrën e tij, të premtën, me 25 shtator. Berlioni është shumë i shqetësuar me deklaratën e KM Hoti për asociacionin tha ai duke shtuar se ai (kryeministri) nuk mund të refuzojë

diskutimin e të gjitha temave për të cilat ai vet është pajtuar që në takimin e parë në Bruksel me presidentin serb Vuçiç.

Menjëhere pas takimit me ambasadorin gjerman, në zyrën e koordinatorit Hyseni erdhi Përfaqesuesi i Posaqëm të BE-së në Kosovë, Tomash Szunyog, i cili shprehu të njejtat shqetësime.

Pa u vonuar koordinatori Hyseni po ate ditë takoi KM Hoti për ta informuar dhe për të diskutuar këtë situatë. U dakorduan që po ate pasdite të therrasim një takim me ambasadorët e Quntit, në mënyrë që ti njoftojmë me rrjedhën e dialogut dhe qëndrimin e KM për asociacionin.

Takimi me ambasadorët e Quntit u mbajt në ora 16:00. KM Hoti rikonfirmoi qëndrimin e tij se ishte i gatshëm të fillonte bisedat në Bruksel për statutin e asociacionit, por u bëri lutje që ta përkrahnin që kjo temë të lihej për një fazë më të vonshme të dialogut, me shpresë se në ndërkohë, spektri politik do të arrinte konsensus rreth kësaj teme.

Shumica ishin dakord që shtyrja për më vonë nuk do duhej të paraqiste problem, meqë ka shumë tema tjera që mund të trajtohen ë ndërkohë.

Kjo assesi nuk duhet të kuptohet se BE-ja apo QUINTI heqin dorë nga obligimi i Kosovës për të zbatuar asociacionin, tërhoqën vërjetjen ata.

Pas këtij takimi, ende ishte e paqartë se kur do të thirrej takimi i radhes delegacioneve të Kosovës dhe Serbisë, për të vazhduar negociatat rreth obligimeve ekonomike.

Në këto rrethana shtrohej pyetja se cialat ishin interesat e Kosovës si shtet dhe si do të duhej adresuar ato, nëse dëshirohej konkludim i suksesshëm i bisedimeve. Përfundimi i dialogut me njohje reciproke Kosovë Serbi ishte interes jetik i Kosovës, dhe Kosova kishte bërë veprimin e duhur politik dhe diplomatik që ishte pajtuar të vazhdonte bisedimet, të cilat për shkakë që diheshin ishin ndërprerë për një kohë të gjatë. Në qarqet



ndërkombëtare, faji për këtë ngecje i vihej Kosovës. Sidoqoftë, teksa ishte hap i qëlluar që sërish po vazhdonin bisedimet me përfaqësuesit më të lartë të Serbisë, poashtu nuk mund te mohohet nga askush që sadopak kishte lidhje me realitetin politik në Kosovë, se fuqizimin e mirefilltë të pozicionit negociator në Bruksel po e dëmtonte seriozisht gara qeshrake midis liderëve në Prishtinë. Këtë situatë e bënte akoma më shqetësuese sjellja, si gjithmonë, përjashtuese e Lëvizjes 'Vetëvendosje' e cila si rëndom vazhdonte të ishte apriori në raporte konfrontuese me çdo gjë dhe me të gjitha forcat tjera politike.

Ndërkohë, pavarësisht sjelljeve të spektrit politik vazhdonin përgatitjet e duhura dhe identifikimi i ekspertëve për gjithë temat që pritej të trajtoheshin në dialog.

Nga zyra e Lajçakut erdhi njoftimi se ai planifikonte të vinte në Kosovë me datën 13 tetor.

Ne të njetat data koordinatori Hyseni kishte konfirmuar udhëtimin në Romë.

Takimet në Romë ishin shumë të rëndësishme. Në kabinetin e Kryeministrit Italian koordinatori Hyseni u prit nga ambasadori Pietro Benassi, këshilltar kryesor diplomatik i kryeministrit Giuseppe Conte. Në të gjitha takimet në Romë u përcoll mesazh i qartë se Italia mbetet fuqimisht e përkushtuar përgjatë gjithë këtij procesi, në përkrahje të fuqishme të një marrëveshje të drejtë, të qëndrueshme dhe gjithpërfshirëse.

Në Parlamentin Italian Hyseni u prit nga Piero Fassino, kryetar i komisionit për politikë të jashtme. Bëmë një bisedë të gjatë dhe të hapur për zhvillimet më të reja në Kosovë dhe rajon.

Si në të gjitha takimet tjera edhe ketu në fokus të bisedës ishte dialogu Kosovë Serbi. Kishte pajtim të plotë me kryetarin Fassino se dialogu duhet të dinamizohet me qëllim të përmbylljes sa më të shpejtë dhe normalizimit të plotë të raporteve midis Kosovës dhe Serbisë përmes njohjes reciproke si e vetmja zgjidhje e qëndrueshme afatgjate.

Një takim tjetër, shumë të frytshëm Hyseni pata në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Italisë, me Sekretarin e shtetit Ivan Scalfarotto.

Pas kthimit nga Roma, koordinatori Hyseni bashku me kryeministrin Hoti, Lajçakun e pritën në Qeveri. A njoftoi për takimet që kishte zhvilluar me liderët tjerë një ditë më parë. Lajçak njoftoi se planifikonte të thërriste takimin e radhës në Bruksel me 20 tetor, për të vazhduar bisedimet rreth obligimeve financiare Kosovë Serbi. Kerkoi dakordimin tonë, të cilin edhe e mori.

Me 21 tetor, koordinatori Hyseni, në zyren e tij priti ambasadorin britanik Nicholas Abbott, të cilit i dorëzoi letrën për pranimin e këshilltarit Boyd McKechnie, të cilin pas dakordimit me kryeministrin Hoti ishte vendosëm të angazhohej si këshilltar me orar të plotë. Ambasadori Abbott, poashtu tha se qeveria e tij ishte e gatshme të ofronte përkrahje financiare për angazhimin sipas nevojës, edhe të ekspertëve tjerë britanik.

Kishin kaluar 6 javë nga takimi i fundit midis delegacioneve të Kosovës dhe Serbisë. Ndërkohë Lajçak kishte vizituar Prishtinën dhe Beogradin ku kishte zhvilluar një varg takimesh në nivele të ndryshme dhe në Beograd kishte lëshuar një deklaratë 'kontradiktore' duke iu referuar asociacionit të komunave me shumicë serbe. "Kushtetuta nuk është bibël që të mos ndryshohet", kishte deklaruar Lajçak gjithnjë simbas raportimeve në medie. Kjo nxiti një vale reagimesh.



Sidoqoftë, diku rreth dates 22 tetor, Lajçak i bëri telefon koordinatorit Hyseni duke njoftuar njoftoi se kishte vendosur të ftonte të dyja delegacionet për një takim të ri për të enjtën, me 29 tetor. Pë këtë mori konfirmin e pjesëmarrjes, ndonëse Beogradi ende nuk kishte pranuar një takim të ri, të cilin vazhdonte ta kushtëzonte me temën e asociacionit.

Një ditë para udhëtimit për Bruksel, në zyren e tij, koordinatori Hyseni mbledhi ekipin për çështje ekonomike me të cilët ishte bërë një punë e madhe në dokumentin dhe argumentimin e qëndrimit të Kosovës rreth temës së pretendimeve ekonomike dhe të pronës. Profesorët Muhamet Mustafa dhe Robert Muharremi, përpos kompetencës dhe dijes, tregonin një shkallë absolutisht kulminante përkushtimi në dialog.

Takimi në Bruksel rrodhi në një atmosferë të rënduar si pasojë e mosgadishmërisë së delegacionit serb për të diskutuar rreth propozimit tonë për zgjidhjen e çështjes së pretendimeve financiare midis dy vendeve. Delegacionin serb e kryesonte Petar Petkoviç i cili kishte marrë drejtimin e delegacionit serb për bisedime pas shkuarjes së Marko Gjuriqit. Ndonëse i ri me moshë, Petkoviç, i takonte asaj mendësisë nacionaliste serbe të viteve 90të. Shihej se delegacioni serb, gjithnjë në linjë me taktikën për zvarritje, nuk kishte asnjë interesim të diskutonte për substancën. Për më tepër, Petkoviç, nxorri një slogan të ri në Bruksel: "përmes zbatimit deri në normalizim" që në terma konkret i binte se s'pari duhej implementuar elementet e marrëveshjes veq e veq, duke përfshirë këtu edhe asociacionin e komunave serbe, e krejt në fund, mbase, edhe do të mund të flitej për një marrëveshje përfundimtare.

Reagimi i koordinatorit Hyseni ishte i ashpër, duke iu drejtuar Petkoviqit ai nënvizoi se "këtu jemi në një process gjithpërfshirës politik i cili pashmagshëm si përfundim do të ketë njohjen zyrtare të Kosovës shtet nga ana e Serbisë. Kosova në këtë process nuk do të pranojë asgjë me

pak se njihen e ndërsjellë. Çfardo marrëveshje e veçantë, përfshirë këtu edhe ato të nënshkruara deri tani në Bruksel, do të fillojnë të zbatohen vetëm pasi Serbia ta ketë njohur Kosovën shtet të pavarur dhe sovran". Ndërhyrjen e tij, koordinatori Hyseni e përfundoi me kërkesën drejtuar ekipit të BE-së që kjo të futej qartë në procesverbal.

Ndërmjetësit Lajçak, i cili ripërseriti qëndrimin se 'nuk ka marrëveshje për asgjë, derisa nuk ka marrëveshje të përgjithshme dhe përfundimtare për normalizim' ishte poashtu i qartë. Pas përfundimit të takimit treplaësh, Lajçak ftoi koordinatorin Hyseni në zyrën e tij për një takim tet-a-tet për siq tha ai, t'u konsultuar nese ishte e nevojshme të thirrej një takim në nivel të lartë me një qëllim të vetëm, e që ishte "qartësimi i pozicioneve" sepse sipas Lajçak, në Prishtinë dhe Bruksel, dialogu behej për marrëveshje përfundimtare dhe se asgjë nuk dakordohej pa marrëveshje gjithëpërfshirëse, ligjerisht të obligueshme për normalizim, ndërsa në Beograd perceptimi i dialogut nuk ishte konsistent.

Pas kthimit në Prishtinë, koordinatori Hyseni takoi kryeministrin Hoti, të cilin e njoftoi me rrjedhën e takimit. Ai u pajtua që të bëhej takimi me 5 nëntor. Mirpo vetëm një ditë pas, Lajçak njoftoi se takimi planifikuar nuk do të mund të mbahej pasi që autoritet belge kishin vendosur që vendi të mbyllej tërësisht si pasojë shpërthimit alarmant të një vale të re të infektimit me Covid-19.

Kjo shënoi edhe fillimin e një faze krejtësisht të paqartë rreth datës së mundshme për vazhdimin e dialogut.

Ndërkohë, në Prishtinë vazhdonte një 'luftë' irracionale midis forcave politike. E krejt këtë situatë e rënduan skajshëm arrestimet, me 4 nëntor,



të ish-krerëve të UÇK-së, Presidentit Hashim Thaçi, kryetarit të PDK-së Kadri Veseli, ish kryetarit të kuvendit Jakup Krasniqi dhe kryetarit të Grupit Parlamentar të VV-së Rexhep Selimi, të cilëve tashmë u ishin konfirmuar aktakuzat nga Dhomat e Specializuara në Hagë.

Arrestimet, përpos dridhjes së madhe që shkaktuan në stabilitetin e vendit, poashtu u bënë edhe shkas i një polarizimi të eksponentëve politik në vend.

Krejt këto zhvillime në Kosovë dhe rreth saj, koincidian edhe me zgjedhjet presidenciale në Amerikë. Gara e rreptë po zhvillohej ndërmjet presidentit aktual, njëherit kandidat republican Donald Trump dhe atij demokrat Joseph Biden.

Perudha në vijim u shfrytëzua për vazhdimin të përgatitjeve për vazhdimin e diskutimit të temes se kërkesave financiare dhe të pronës midis Kosovës dhe Serbisë.

Koordinatori Hyseni, me ekipin që e përbenin: professor Muhamet Mustafa, Robert Muharremi dhe Bernard Nikajn finalizuan finalizuan dokumentin e qendrimit të Kosovës rreth kadastrit dhe pensioneve, tema këto të cilat siq ishte paralajmëruar, do të shtroheshin për diskutim në takimin e radhës.

Ndërkohë u zhvilluan shumë takime konsultative me ekspertë fushash të ndryshme. Qeveria norvegjeze kishte ofruar perkrashje financiare për angazhimin e eksperteve të jashtëm të cilët do të ndihmonin në procesin e dialogut edhe zyren time edhe zyren e kryeministrit. U vendos që në këtë

pako fillimisht të përfshiheshin Muhamet Mustafa, Robert Muharremi dhe Bernard Nikajn të cilët po punonin pa asnjë kompenzim financiar.

Me 30 nëntor koordinatori takoi kryeministrin Hoti. Biseduan për të gjitha këto çështje dhe u dakorduan me emrat e propozuar.

Po ate ditë, Lajçak dergoi ftesat dhe propozoi që takimi i radhës në nivel kryenegociatoresh të thirrej për datën 10 dhjetor. Me 2 dhjetor, arriti ftesa dhe agjenda për takim në Bruksel me 10 dhjetor. Tema diskutimi, pensionet dhe kadastrin.

Ne përgjigjen e tij Koordinatori Hyseni, Lajçakut i konfirmoi pjesëmarrjen e tij në krye të delegacionit të Kosovës, ku ishin edhe Muhamet Mustafa, Bernard Nikaj, Robert Muharremi.

I gjithë delegacioni arriti në Bruksel me datën 9 dhjetor.

Që në fillim të takimit, Petković nxorri një tavolinë një propozim tërësisht të ri, ndonëse në takimin paraprak ishte rënë dakord që do të diskutohen vetëm propozimet e dorëzuara më heret, sipas afatit të përcaktuar nga ndërmjetësi. Ky veprim i delegacionit serb, nga Lajçak u pa si manovër për t'i ikur ballfaqimit me argumentet që përmbante dokumenti jonë, përkatësisht Qëndrimi i Republikës së Kosovës për Pensionet dhe Kadastrin, që e ishte dorëzuar 10 ditë më heret. Delegacioni serb kishte patur kohë të mjaftueshme që ta analizonte dhe komentonte. Lajçak e ndërpreu takimin.

Pra, Në raundet e deritashme, si në nivel të koordinatorëve për dialog, ashtu edhe në nivel të lartë, është diskutuar për të pagjeturit dhe të zhvendosurit, raportet ekonomike dhe është filluar të trajtohet edhe



çështja e obligimeve financiare dhe pronës. Derisa për tre elementët e para të marrëveshjes është arritur një pajtim në parim, për obligimet financiare dhe pronën, bisedimet midis Kosovës dhe Serbisë janë duke vazhduar. Nuk ka ende asnjë dakordim në parim rreth këtij elementi, sepse deri më tani nuk ka pasë përafrim të qëndrimeve.

Sipas paralajmërimeve nga zyra e z. Lajçak, trajtimi i kësaj çështjeje do të vazhdohet pas vitit të ri.

Kosova ka hyrë në këtë proces seriozisht, dhe do ta ruaj seriozitetin e angazhimit në frymë konstruktive, me insistimin eksplicit tek ndërmjetësi i dialogut për të përmbyllur marrëveshjen e përgjithshme vetëm me njohje reciproke, duke respektuar plotësisht rendin kushtetues të Kosovës, duke respektuar unitaritetin qeverisës dhe integritetin territorial.

Pra, duhet theksuar qartë se Kosova nuk ka marrë, dhe nuk do të merr asnjë zotim të veçantë, pa pranuar Serbia njohjen e Kosovës si shtet i pavarur, në kufijtë ekzistues dhe me këtë rend kushtetues.

Prishtinë, 28 dhjetor 2020



Skender Hyseni

Koordinator Shtetëror për Dialog